

VENDIM
Nr. 19, datë 13.1.2022

PËR MIRATIMIN E KUADRIT MAKROEKONOMIK E FISKAL
PËR PERIUDHËN 2023–2025

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 27, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2023–2025, si dhe të lidhjeve nr. 1, “Treguesit kryesorë makroekonomikë”, nr. 2/1 e nr. 2/2, “Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar”, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.
 2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

KUADRI MAKROEKONOMIK DHE FISKAL 2023–2025
Janar, 2022

Tabela e përmbajtjes

Shkurtime

Hyrje

1. Zhvillimet më të fundit makroekonomike

2. Politikat fiskale

3. Parashikimet e treguesve makroekonomikë dhe fiskalë

Metodologjia e parashikimeve makroekonomike

Skenari makroekonomik e fiskal afatmesëm

Lidhja nr. 1 “Treguesit kryesorë makroekonomikë”

Lidhja nr. 2/1 “Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në milionë lekë)”

Lidhja nr. 2/2 “Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në përqindje të PBB-së)”

Shkurtime

BB	Banka Botërore
BSH	Banka e Shqipërisë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
INSTAT	Instituti i Statistikave
KM	Këshilli i Ministrave
KMF	Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal
LOB	Ligji organik i buxhetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PBA	Programi buxhetor afatmesëm
PBB	Produkti i brendshëm bruto
SPI	Sistemi i planifikimit të integruar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
WEO	World Economic Outlook

KUADRI MAKROEKONOMIK DHE FISKAL 2023–2025

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Hyrje

Kuadri Makroekonomik e Fiskal (KMF) për periudhën 2023–2025 është pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe përgatitet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. KMF-ja ka për qëllim përcaktimin e përparësive strategjike të qeverisë. Ai projekton pritshmërinë makroekonomike në horizontin kohor afatmesëm, si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Ai përcakton synimet dhe objektivat e qeverisë në lidhje me treguesit kryesorë të politikës fiskale, si balancën e përgjithshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, balancën fiskale primare dhe atë korrente. KMF-ja shërben si bazë për përcaktimin e taveve në fazën e parë të procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2023–2025 në nivel ministrie.


KMF-ja miratohet nga Këshilli i Ministrave në muajin janar të çdo viti, dhe mund të jetë sërish subjekt rishikimi dhe përditësimi përgjatë vitit, përpara finalizimit të PBA-së dhe të taveve për shpenzimet.

KMF-ja përmban dy komponentë kryesorë: i) parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomikë, të cilët paraqesin pritshmërinë ekonomike për vitin aktual dhe tre vjetët e ardhshëm; dhe ii) parashikimet dhe objektivat për treguesit fiskalë, të cilët paraqesin burimet e pritshme në dispozicion të qeverisë për vitet 2023–2025 dhe shpërndarjen e tyre për këtë periudhë sipas buxhetit të konsoliduar. Këta komponentë paraqiten në mënyrë tabelore në fund të këtij dokumenti, përkatësisht lidhja nr. 1; lidhja nr. 2/1 dhe lidhja nr. 2/2.

1. Zhvillimet më të fundit makroekonomike

Ritmi i rritjes ekonomike gjatë viteve të fundit, deri përpara goditjes nga pandemia e COVID-19, ka treguar një trend pozitiv zhvillimi që është pasqyruar në një sërë parametrash makroekonomikë në vend. Performanca e vitit 2020 ka qenë, në aspektin ekonomik dhe të financave publike, një ndër vitet më të vështira në tri dekada. Ekonomia e vendit përjetoj dy goditje të forta brenda një harku kohor të shkurtër që përfshin tremujorin e katërt të vitit 2019 dhe vitin 2020, veçanërisht në tremujorin e dytë dhe të tretë të tij. Në muajin nëntor të vitit 2019, vendi u godit nga një tërmet tepër i fortë që solli dëme në njerëz dhe në ekonomi, ndërsa në muajin mars të vitit 2020 pandemia e COVID-19 u përhap edhe në Shqipëri, masat e ndërmarra ndaj së cilës impaktuan ndjeshëm aktivitetin ekonomik në vend.

Sidoqoftë, me gjithë ndikimin e rëndë që të dyja goditjet kanë pasur për ekonominë e vendit, në sajë të përgjigjeve relativisht mjaft të mira të politikave ekonomike dhe masave të duhura rregullatore të ndërmarra, të dhënat statistikore të disponueshme dëshmojnë se situata e përgjithshme në mbyllje të vitit 2020 ishte konsiderueshëm më pak e rëndë nga sa pritej në fillim të pandemisë, si dhe përgjatë vitit 2021 rimarrja e ritmit të ekonomisë është konsiderueshëm më e shpejtë sesa pritshmëritë fillestare.



Burimi: INSTAT

Viti 2020 regjistroi një recesion prej 3.96 për qind, e cila për shkak të pandemisë arriti kulmin e tkurrjes së PBB-së në tremujorin e dytë në -11.3 për qind, por duke shfaqur shenja rimëkëmbje e duke u rikthyer përsëri në terren pozitiv në tremujorin e fundit të vitit e në vijim. Gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2021, ekonomia e vendit shfaq shenja mjaft inkurajuese duke shënuar rikuperim të shpejtë të aktivitetit ekonomik. Ky rikuperim mbështetet në një gamë të gjerë faktorësh dhe është prezent në thuajse të gjithë sektorët e ekonomisë. Reduktimi (pothuajse heqja fare) i kufizimeve pas rënies së infektiveve, ku një rol të rëndësishëm ka pasur edhe procesi vaksinimit, rritja e besimit të biznesit e konsumatorit, përmirësimi i ekonomive partnere, si dhe politikat mbështetëse fiskale e monetare, kanë sjellë rritje të konsumit të familjeve, të investimeve publike e private dhe të eksporteve.

Sipas vlerësimeve më të fundit nga INSTAT-i, PBB-ja reale u rrit me 5.61 për qind në terma vjetorë në tremujorin e parë të vitit 2021, duke u pasuar nga një zgjerim i konsiderueshëm prej 18.38 për qind në tremujorin e dytë dhe vijoi trajektoren pozitive me një rritje prej 6.99 për qind në tremujorin e tretë, krahasuar me tremujorët respektivë të vitit 2020. Ndërsa në terma nëntëmujorë për vitin 2021, ekonomia ka shënuar rritje me 10.38 për qind kundrejt së njëjtës periudhë të 2020-s.

Sipas optikës së kërkesës agregate, sipas vlerësimeve të deritanishme, rritja përgjatë vitit 2021 duket të jetë gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat ashtu edhe nga investimet. Ndërkohë, kërkesa e jashtme neto ka pasur një efekt neto më të moderuar. Eksportet, si të mallrave ashtu edhe të shërbimeve (veçanërisht turizmi), ka pasur një ecuri të mirë, por njëkohësisht edhe importet kanë regjistruar po ashtu një rritje të fortë (në reflektim të rritjes së kërkesës agregate, veçanërisht investimeve), e për rrjedhojë kontributi neto i kërkesës së huaj ka qenë pozitiv, por ndjeshëm më i moderuar se ai i kërkesës së brendshme.

Konsumi final për nëntëmujorin 2021 ka shënuar rritje prej 5.6 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të 2020, me një kontribut pozitiv në rritjen e PBB-së prej rreth 3.35 pikë përqindje, ndërsa konsumi final i popullatës u rrit me rreth 5.30 për qind. Ndërkohë, vetëm për tremujorin e tretë konsumi final total dhe ai i popullatës shënuan një normë rritje në respektivisht 3.75 për qind dhe 3.33 për qind.

Formimi i kapitalit fiks bruto (investimet totale) shënoi rritje të fortë me rreth 20.15 për qind në terma real vjetorë përgjatë nëntë muajve të vitit 2021 dhe me kontribut prej 3.25 pikë përqindje, ndërkohë vetëm për tremujorin e tretë të vitit 2021 kjo normë ishte 3.84 për qind.

Referuar statistikave të llogarive kombëtare tremujore të INSTAT-it, përgjatë nëntë muajve të vitit 2021, eksportet e mallrave dhe shërbimeve kanë pasur një rritje të fortë prej rreth 55 për qind, ndërsa po ashtu rritja ka qenë e fortë edhe në importet e mallrave dhe shërbimeve prej rreth 31 për qind.

Nga pikëpamja e ofertës agregate, sektorët, të cilët kanë shënuar rritjen më të fortë përgjatë periudhës nëntëmujore të vitit 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë: “Industria”, me rritje prej 23.9 për qind dhe kontribut pozitiv prej 3.06 pikë përqindje; “Tregtia me shumicë dhe pakicë”, me rritje me 13.88 për qind dhe kontribut prej 1.98 pikë përqindje; “Ndërtimi”, me rritje prej 20.7 për qind dhe kontribut prej 1.77 pikë përqindje; “Aktivitete financiare dhe të sigurimit”, me rritje prej 24.2 për qind dhe kontribut pozitiv prej 0.75 pikë përqindje; si dhe “Arte, argëtim dhe çlodhje”, me rritje prej 11.6 për qind dhe kontribut prej 0.22 pikë përqindje etj. Sektori i vetëm që ka pësuar rënie është “Bujqësia”, me rënie prej -0.15 për qind dhe kontribut prej -0.03 pikë përqindje.

Dinamika në tregun e punës ka reflektuar përgjithësisht atë të aktivitetit ekonomik, me një vonesë kohore që karakterizon korrelacionin midis këtyre dy tregjeve. Referuar anketës tremujore të forcës së punës nga INSTAT-i, situata aktuale në numrin total të të punësuarve po përmirësohet, pas gati tre tremujorëve me rënie dhe në tremujorin e tretë të 2021-shit ishte pothuajse në nivelet e para krizës (fund-2019). Ndërkohë që viti 2020 rezultoi me një rritje të lehtë të shkallës së papunësisë me një nivel mesatar për gjithë vitin prej 12.2 për qind (për grupmoshën 15-64 vjeç), norma e papunësisë regjistroi nivelin prej 12.6 për qind në tremujorin e parë

të 2021-shit, 12.1 për qind në të dytin dhe ra më tej në 11.6 për qind në tremujorin e tretë 2021. Norma mesatare e papunësisë për nëntëmujorin e 2021 ishte 12.1 për qind, duke qëndruar pothuajse në të njëjtin nivel prej 12.2 për qind të nëntëmujorit të 2020-s. Ndërkohë, për grupmoshën 15 vjeç e lart, norma e papunësisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021 regjistroi nivelin prej 11.3 për qind, me një rënie prej 0.5 pikë përqindje nga tremujori i tretë i 2020-s.


Bazuar në statistikën e bilancit të pagesave të BSH-së, bilanci i pagesave (BP) për vitin 2020 regjistroi një tepricë pozitive prej 654.7 milionë euro, ndërsa për nëntëmujorin e vitit 2021 bilanci i pagesave regjistroi një tepricë pozitive prej 210 milionë eurosh, kundrejt një balance pozitive prej 797.4 milionë eurosh në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Deficiti i llogarisë korrente për nëntëmujorin 2021 shënon një deficit prej 670 milionë eurosh, i ngushtuar krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë me rreth 134 milionë euro ose 16.6 për qind. Përmirësimi i deficitit korrent është diktuar nga zgjerimi i suficitit tregtar në shërbime me rreth 608 milionë euro ose 80.7 për qind kundrejt nëntëmujorit të 2020-s, në reflektim të rritjes së konsiderueshme të të ardhurave nga “udhëtimet” gjatë sezonit veror. Eksporti i shërbimeve të lidhura përgjithësisht me turizmin u zgjerua në vlerën 1.5 miliardë euro për nëntëmujorin 2021 ose rreth dy herë më shumë krahasuar me 731.7 milionë euro në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Nga ana tjetër, deficiti tregtar rezultoi me një zgjerim prej rreth 502 milion euro ose 24 për qind krahasuar me nëntëmujorin e 2020-s. Eksporti i mallrave për nëntëmujorin 2021 u rrit me 62.2 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të 2020, por në të njëjtën kohë edhe importi i mallrave u zgjerua ndjeshëm me rreth 32 për qind, në reflektim të rritjes së kërkesës së brendshme stimuluar edhe nga sezoni turistik. Pështetja ndjeshëm më e lartë e importeve të mallrave në raport me eksportet çoi për rrjedhojë në zgjerimin e balancës tregtare. Remitancat për periudhën nëntëmujore të vitit 2021 shënuan vlerën 540 milionë euro, me një rritje prej rreth 14.7 për qind krahasuar me 470 milionë euro në periudhën respektive të një viti më parë. Në nëntëmujorin e parë të vitit 2021, teprica pozitive e llogarisë financiare dhe kapitale u ngushtua në 703 milionë euro krahasuar me 1.5 miliardë euro në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Brenda kësaj llogarie, flukset neto “jo-borxh-krijuese” në trajtën e investimeve të huaja direkte shënuan nivelin prej +736 milionë euro për nëntëmujorin e parë të vitit 2021, pothuajse në të njëjtin nivel prej +731 milionë euro të së njëjtës periudhë të 2020.

Inflacioni mesatar përgjatë vitit 2020 ishte 1.6 për qind. Ndërsa inflacioni mesatar për periudhën janar – nëntor të vitit 2021 është 1.9 për qind. Kursi i këmbimit të lekut kundrejt valutave kryesore ka qëndruar përgjithësisht mjaft stabil. Kursi mesatar lek/euro për janar-nëntor 2021 ishte 122.6 nga 123.8 që ishte mesatarisht gjatë të njëjtës periudhë të 2020. Ndërsa kursi mesatar lek/USD për janar-nëntor 2021 ishte 103.2 nga 109.3 që ishte mesatarisht gjatë 2020.

2. Politikë fiskale

Pas një stimuli të lartë, të domosdoshëm dhe njëkohësisht të paevitueshëm gjatë viteve 2020 dhe 2021 me qëllim amortizimin e goditjeve negative (tërmeti dhe sidomos pandemia), politika fiskale për periudhën afatmesme 2023–2025 do të ri-orientohet sërish drejt konsolidimit fiskal, ndërkohë që do sigurojë një nivel investimesh publike relativisht të lartë prej mesatarisht rreth 5.3 për qind të PBB në vit (vetëm nga qeveria qendrore). Konsolidimi fiskal dhe reduktimi i borxhit publik është thelbësor për uljen e risqeve makroekonomike, të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike. Objektivat e politikës fiskale në KMF 2023–2025 janë në përputhje të plotë me parimet dhe rregullat fiskale të ligjit organik të buxhetit (shih kuadratin në faqen 8).

Ky kuadër fiskal synon një deficit fiskal të përgjithshëm prej 2.9 për qind të PBB-së për 2023, nga 5.4 për qind i programuar për vitin 2022; dhe nivelin prej 2.8 për qind të PBB-së në vitin 2024 dhe 2025. Njëkohësisht, si rrjedhojë e dy goditjeve të njëpasnjëshme, fillimisht nga tërmeti dhe më pas shumë më fort nga pandemia COVID-19, balanca primare pritet jetë në balancë (normën 0) në vitin 2023, me përmirësim të fortë nga niveli negativ prej 2.7 për qind i PBB-së i targetuar për 2022-n, ndërkohë që targetohet në vijimësi rikthimi në vlera pozitive që prej vitit 2024 me 0.3 për qind dhe 0.4 për qind në vitin 2025.



Lidhur me balancën primare, i cili është një parametër shumë i rëndësishëm i qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike, në Korrik të 2020 u ndërmor një tjetër iniciativë ligjore duke përfshirë një rregull të ri fiskal në LOB, në linjë edhe me rekomandimet e KE-së dhe me parimet kryesore të “aquis” të BE, i cili bën të detyrueshëm ligjërisht tashmë që duke filluar që prej vitit buxhetor 2024 e në vijim balanca primare faktike nuk mund të rezultojë negative, pra duhet të jetë së paku e balancuar ose pozitive (suficit primar).¹ Ky target i parametrit të balancës primare buxhetore do të përbëjë tashmë dhe në vijimësi objektivin kryesor operativ të politikës fiskale për të materializuar synimin e një trajktore vijimësisht rënëse të borxhit publik, pra duke synuar konsolidim të vijueshëm fiskal me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së financave publike si një fundament kyç i stabilitetit makroekonomik dhe mbarë-vajtjes së ekonomisë së vendit. Më konkretisht, duke marrë të mirëqena supozimet dhe projeksionet e tjera të KMF-së aktuale, respektimi në mënyrë të përvitshme i këtij objekti (rregulli fiskal) të parametrit të balancës primare, pritet të çojë në një reduktim të nivelit të borxhit publik bruto rreth nivelit prej 74.6 për qind të PBB-së deri në vitin 2025 nga rreth 80.1 për qind që pritet të rezultojë më 2021.

Parimet dhe rregullat fiskale

Në përputhje të plotë me obligimet që rrjedhin prej ligjit organik të buxhetit (LOB) nr. 9936/2008, të ndryshuar, KMF 2023–2025 materializon parimet dhe rregullat fiskale të mëposhtme:

1. Në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe të qëndrojë poshtë nivelit 45 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, KMF 2023–2025 *targeton çdo vit një nivel të borxhit publik total në përqindje të PBB-së më të ulët se sa niveli i vitit pararendës.*

2. Vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin “Perspektiva ekonomike botërore” (*World Economic Outlook*), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqërues të ligjit vjetor të buxhetit.

¹ Rregulli origjinal sanksiononte “që prej 2023”, por më pas kjo u ndryshua sërish në korrik të 2021-s dhe u bë “që prej 2024”.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, KMF 2023–2025 bazohet në projeksionet e mëposhtme të PBB-së nominale, të cilat paraqiten në mënyrë krahasimore kundrejt projeksioneve më të fundit të FMN-së. Në këtë rast, sipas shënimit të bërë në WEO më të fundit të publikuar në muajin tetor 2021, ku thuhet se: “Projeksionet WEO u përgatitën përpara fillimit të misionit të artikullit IV, që përfundoi më datë 11 tetor 2021 dhe kështu nuk pasqyrojnë përditësimet e bëra gjatë misionit”, për referencë janë marrë shifrat e PBB-së nominale të misionit më të fundit të FMN-së (misioni i artikullit IV, i kryer në tetor 2021).

Parashikimet e PBB nominale të MFE dhe FMN		(në miliardë Lekë)					
	2019	2020	2021 <i>Para.</i>	2022 <i>Para.</i>	2023 <i>Para.</i>	2024 <i>Para.</i>	2025 <i>Para.</i>
MFE	1,691.7	1,617.5	1,769.3	1,867.4	1,964.8	2,070.9	2,183.2
FMN	1,691.7	1,617.5	1,769.3	1,867.5	1,964.9	2,071.0	2,183.3
Diferenca MFE - FMN (Diferenca e vlerave të parashikuara duhet të jetë jo më e madhe se zero)	0.0	0.0	0.0	-0.2	-0.2	-0.1	-0.1

3. Në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontingjencë e veçantë, prej jo më pak se 0.7 për qind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, Kuadri 2023–2025 përfshin për çdo vit në një zë të veçantë të tij, emërtuar “Kontingjencë për luhatjet e normave të interesit etj.” një kontingjencë prej mbi 0.7 për qind e shpenzimeve totale.

4. Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 për qind, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 4/1 të ligjit organik të buxhetit nr. 57/2016, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, Kuadri 2023–2025 nuk përfshin të hyra nga privatizimet e mundshme.

5. Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal – “rregulli i artë”) të LOB, deficit i targetuar në Kuadrin 2023–2025 është çdo vit më i ulët se sa shpenzimet kapitale të planifikuara. Rrjedhimisht, balanca korrente e targetuar është pozitive prej mesatarisht 2.4 për qind të PBB në çdo vit të programuar.

6. Në çdo vit buxhetor që prej vitit 2024 e në vijim, balanca primare faktike nuk mund të rezultojë negative, pra duhet të jetë të paktën e balancuar ose pozitive (suficit primar).

Në përputhje me këtë dispozitë, Kuadri 2023–2025 targeton një balancë primare pozitive në vitin 2024 me 0.3 për qind dhe 0.4 për qind në vitin 2025.

1. Linku për raportin “WEO” – <https://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2021/10/12/world-economic-outlook-october-2021>

3. Parashikimet e treguesve makroekonomikë dhe fiskalë

Metodologjia e parashikimeve makroekonomike

Parashikimi i treguesve makroekonomikë afatmesëm dhe i tërësisë së elementeve përbërëse të kuadrit makroekonomik është bazuar kryesisht në metodat modeluese dhe analitike të programimit financiar. Skenari bazë i kuadrit makroekonomik, mbështetet në linjën aktuale të politikave makroekonomike, në linjën aktuale të politikave e reformave ekonomiko-strukturore qeveritare, në sjelljen dhe në bashkëveprimin racional të agjentëve ekonomikë brenda kontureve të ambientit të brendshëm e të jashtëm makroekonomik, i cili vlerësohet si më i mundshmi për periudhën afatmesme në vijim. Në kryerjen e këtyre parashikimeve janë ngritur një set supozimesh bazë, si dhe janë përdorur një set i gjerë të dhënash statistikore makroekonomike të gjeneruara prej institucioneve, si: INSTAT-i, BSH-ja, MFE-ja, FMN-ja, BB-ja, Eurostat-i etj.

Këto statistika janë kryesisht në formën e serive kohore me frekuencë vjetore, tremujore e mujore. Kohëzgjatja e tyre e marrë në konsideratë për ndërtimin e këtij kuadri është përgjithësisht që prej vitit 1996. Pasi janë ndjekur të gjitha etapat metodologjike të parashikimit, skenari bazë i përfituar synon të paraqesë situatën makroekonomike përgjithësisht më të mundshme dhe maksimalisht konsistente në aspektin e një ekonomie të plotë e integrale.

Objektivat themelorë të miksit të politikave fiskale e monetare përgjatë tre vjetëve në vijim nëpërmjet të cilave synohet ruajtja dhe konsolidimi i mëtejshëm i stabilitetit makroekonomik të vendit, krijimi i klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike, si dhe konvergimi sa më shpejt drejt nivelit mesatar të mirëqenies të Bashkimit Evropian, janë:

- Synimi i një trajektore rënëse të borxhit publik duke targetuar si objektiv operativ vjetor rikthimin e buxhetit në një balancë primare të balancuar ose me suficit prej vitit buxhetor 2024 dhe në vijim. Ky objektiv është ligjërish i detyrueshëm në LOB.

- Mbajtja e një niveli të investimeve publike mbi nivelin e deficitit të përgjithshëm fiskal në çdo vit dhe mundësisht mbi nivelin 5 për qind të PBB-së mesatarisht çdo vit.

- Ruajtja e stabilitetit të çmimeve, si objektiv themelor i politikës monetare, e cila targeton një normë inflacioni në nivelin 3.0 për qind, në një periudhë afatmesme dhe ankorimin e pritshmërive të tij rreth këtij niveli. Harmonizmin e politikës fiskale me këtë objektiv themelor të politikës monetare me qëllim për të mbështetur rritjen afatgjatë ekonomike të vendit.

- Zbutja e deficitit të llogarisë korrente dhe përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë duke tentuar rritjen graduale të nivelit të rezervave valutore, dhe duke ruajtur të paktën një nivel dysheme të tyre, të mjaftueshëm për të financuar jo më pak se 4 muaj import mallrash dhe shërbimesh.

Këta objektiva fundamentale përbëjnë konturet bazë të këtij programi ekonomik e fiskal brenda të cilave përcaktohen projeksionet dhe programohen të gjithë variablat e tjerë makroekonomikë e fiskalë.

Skenari makroekonomik e fiskal afatmesëm

Pas recesionit të fortë prej -4 për qind në vitin 2020, ekonomia ka nisur të rimëkëmbet fuqishëm në vitin 2021, parashikuar në normën prej 8.7 për qind dhe parashikohet të vijojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme në vijim. Rritja ekonomike parashikohet në normën 4.1 për qind në vitin 2022 dhe parashikohet mesatarisht rreth 4 për qind në vit përgjatë periudhës afatmesme në vijim 2023–2025. Më specifikisht, rritja ekonomike parashikohet në 4.2, 3.9 dhe 3.9 për qind respektivisht për vitet 2023, 2024 dhe 2025.

Gjatë periudhës afatmesme rritja pritët të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi ashtu edhe investimet. Ndërkohë kërkesa e huaj neto (eksport–import) pritët të ketë një efekt të moderuar pozitiv. Konsumi privat parashikohet të jetë sërish nxitësi kryesor i rritjes së PBB-së, stimuluar kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimi në tregun e punës. Këto të fundit priten të transmetohen në një rritje graduale të pagave të cilat më tej pritët të stimulojnë të ardhurat reale të disponueshme të individëve, duke krijuar efektin e raundit të dytë në nxitjen e konsumit, si dhe duke intensifikuar prirjen e konsumatorëve për financimin e mëtejshëm të konsumit nëpërmjet një kredimarrje më të lartë. Ndërkohë, kredimarrja për konsum parashikohet të nxitet edhe nga përmirësimi i pritshëm i kushteve financiare të individëve, ashtu edhe nga lehtësimi i pritshëm i standardeve të huadhënies nga sistemi bankar në periudhën afatmesme, pas kapërcimit të efektit negativ nga goditja e pandemisë.

Ndërsa rritja graduale e investimeve pritët të nxitet nga një shfrytëzim më i intensifikuar i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, si dhe nga përshpejtimi i aktivitetit ekonomik gjatë periudhës së parashikuar dhe perceptimi i përmirësuar i biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme e afatgjatë. Njëkohësisht edhe përmirësimi i kushteve financiare dhe lehtësimit të standardeve të huadhënies priten të jenë një faktor i rëndësishëm incentivues i investimeve private në afatin e mesëm.


Specifikisht, konsumi final total për periudhën afatmesme (2023–2025) parashikohet të rritet në terma real me mesatarisht rreth 2.7 për qind në vit, duke kontribuar me mesatarisht rreth 2.5

pikë përqindje në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa investimet totale në ekonomi parashikohen të rriten në terma real mesatarisht në rreth 3.9 për qind në vitet 2023–2025, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 0.9 pikë përqindje në vit.

Kërkesa e huaj neto pritet të ketë një kontribut pozitiv të moderuar në periudhën afatmesme. Eksportet e mallrave të cilat zakonisht kanë pasur performancë të mirë në vite, priten të vazhdojnë këtë trend pozitiv dhe të ruajnë ritmet e kaluara. Eksportet e shërbimeve, veçanërisht shërbimet turistike, priten gjithashtu të rikthejnë performancën pozitive në periudhën afatmesme dhe të jenë elementi kryesor për të kompensuar kontributin negativ të ardhur prej rritjes së importeve.

Sa u takon më specifikisht komponentëve të kërkesës së huaj neto, eksportet e mallrave dhe shërbimeve për periudhën 2023–2025, parashikohen të rriten me mesatarisht rreth 6.2 për qind në vit në terma real, me një kontribut mesatar pozitiv prej rreth 1.8 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa importet e mallrave dhe shërbimeve për këtë periudhë afatmesme parashikohen të zgjerohen me mesatarisht rreth 2.9 për qind në vit me një kontribut mesatar negativ në rritjen e PBB-së me rreth 1.2 pikë përqindje në vit. Rrjedhimisht, në terma neto, kërkesa e huaj parashikohet të ketë një kontribut lehtësisht pozitiv në rritjen totale të PBB-së me mesatarisht rreth 0.6 pikë përqindje në vit.

Grafik. Rritja reale (majtas, në për qind) dhe kontributet në rritje (djathtas, në p.p.) sipas komponentëve të kërkesës agregate



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë


Megjithëse politika fiskale do të vazhdojë të jetë e orientuar drejt konsolidimit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, politika buxhetore e qeverisë për të ruajtur një nivel të investimeve publike në mbi 5 për qind të PBB-së në vitet 2023–2025 do të stimulojë formimin e kapitalit fiks bruto në ekonomi, esenciale kjo për të mbështetur nivele relativisht të larta rritje në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Në të njëjtën kohë, pritshmëritë për vijimin e kushteve relativisht të favorshme për financim në tregun financiar, do të mbështesë konsumin privat dhe investimet.

Konsolidimi fiskal i synuar nga qeveria do të kufizojë kërkesën e përgjithshme të sektorit publik. Si i tillë, nuk pritet të jetë një nxitës i rritjes në periudhën afatmesme. Megjithatë, konsolidimi fiskal do të ulë primin e riskut në periudhën afatmesme dhe do të rrisë hapësirat për stimul në sektorin privat, fundamente mjaft të rëndësishme këto për sigurimin e një rritje të lartë e të qëndrueshme. Në të njëjtën kohë, komponentët e politikave buxhetore të planifikuara do të mbështesin rritjen dhe për këtë arsye efekti shtrëngues i konsolidimit fiskal pritet të kompensohet.

Nga pikëpamja e ofertës agregate pritet që të gjithë sektorët kryesorë të vazhdojnë të rriten pak a shumë me të njëjtin trend të mesatares së tyre historike. Specifikisht, bujqësia pritet të rritet mesatarisht me rreth 2.2 për qind në vit në terma realë përgjatë periudhës 2023–2025, me një kontribut mesatar vjetor në rritjen ekonomike prej rreth 0.4 pikë përqindje; Industria me një rritje

mesatare vjetore prej rreth 4.5 për qind dhe një kontribut mesatar vjetor prej rreth 0.5 pikë përqindje; Ndërtimi me rritje mesatare vjetore prej rreth 3.1 për qind dhe kontribut mesatar vjetor prej rreth 0.3 pikë përqindje; shërbimet me një rritje mesatare vjetore prej rreth 4.7 për qind dhe një kontribut mesatar vjetor prej rreth 2.3 pikë përqindje.


Grafik. Rritja reale (majtas, në për qind) dhe kontributet në rritje (djathtas, në p.p.) sipas komponentëve të ofertës agregate



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në përputhje me parashikimet afatmesme të rritjes, punësimi pritet të rritet me një mesatare prej rreth 0.9 për qind në vit gjatë viteve 2023–2025. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës do të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes së ofertës së punës. Ndërsa rritja e kërkesës për punë pritet të reflektojë pothuajse të njëjtën strukturë të perspektivës së ofertës agregate të aktivitetit ekonomik. Rrjedhimisht, pritet që shërbimet të kontribuojnë më shumë në rritjen e kërkesës për punë në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë. Krahas zgjerimit të pritshëm të punësimit në afatin e mesëm, pritet që edhe produktiviteti i përgjithshëm i punës të vijojë një përmirësim gradual gjatë kësaj periudhe.

Grafik. Punësimi (në të majtë, rritja vjetore në për qind) dhe norma e papunësisë (në të djathtë, në për qind)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë


Presionet inflacioniste parashikohet të forcohen në periudhën afatmesme. Presionet e brendshme inflacioniste priten të përshpejtohen si rezultat i rritjes së konsumit privat dhe investimeve, të cilat do të mbështesin një ritëm më të shpejtë të rritjes ekonomike. Për më tepër, parashikimi për forcimin e kërkesës agregate dhe inflacionit në mjedisin ndërkombëtar pritet të

përçojnë një efekt inflacionist disi më të rritur në ekonominë shqiptare për periudhën afatmesme në vijim. Inflacioni pritet të rritet gradualisht dhe të rikthehet në objektivin e politikës monetare në afatin e mesëm.

Parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomikë paraqiten në lidhjen nr. 1 bashkëngjitur VKM

Bazuar mbi parashikimet e treguesve kryesorë makroekonomikë, reformave dhe ndryshimeve fiskale të ndërmarra dhe veçanërisht ato të pritshme për t'u ndërmarrë në vijim, përfshirë këtu implementimin e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave, e cila synon të përmirësojë politikat tatimore për mbledhjen e tatimeve, përputhshmërisë dhe sistemeve të monitorimit, si dhe të faktorëve të tjerë përcaktues në ecurinë e zërave të ndryshëm të të ardhurave të buxhetit të shtetit, të ardhurat totale të buxhetit për tre vitet në vijim (2023–2025) parashikohet të rriten mesatarisht me rreth 5.9 për qind në çdo vit. Më specifikisht 6.1 për qind për vitin 2023, 5.6 për qind për 2024 dhe 5.8 për qind për 2025. Të ardhurat tatimore për këtë periudhë parashikohen me një rritje mesatare vjetore prej rreth 6.2 për qind.


Grafik. Të ardhurat (majtas në miliardë lekë, djathtas në për qind të PBB-së)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Duke qëndruar brenda kontureve të parashikimeve të treguesve makroekonomikë dhe të të ardhurave për tre vjetët në vijim, si dhe duke synuar respektimin e objektivave të sipërpërmendur të deficitit fiskal për këtë periudhë, burimet totale të qeverisë për t'u shpenzuar gjatë viteve 2023–2025 pritet të jenë mesatarisht në rreth 662.3 miliardë lekë në çdo vit ose mesatarisht rreth 32 për qind e PBB-së. Investimet publike janë programuar të mbahen në një nivel mesatarisht prej rreth 5.3 për qind të PBB-së në çdo vit (vetëm nga qeveria qendrore, pa përfshirë ato nga qeveria lokale), i cili konsiderohet një nivel i përshtatshëm për mbështetjen e një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme.

Grafik. Shpenzimet (majtas në miliardë lekë, djathtas në për qind të PBB-së)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Parashikimet e të ardhurave sipas zërave të buxhetit të konsoliduar, si dhe niveli i shpenzimeve të shpërndara sipas zërave të buxhetit të konsoliduar paraqiten në lidhjet nr. 2/1 dhe nr. 2/2 bashkëngjitur VKM, respektivisht në terma nominalë dhe në raport me PBB-në.

Lidhja nr. 1 – Treguesit kryesorë makroekonomikë

Treguesit	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
					Vler.	Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	2.9	2.9	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8
Inflacioni (mesatar)	%	2.0	1.4	1.6	2.0	2.8	3.0	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	1.4	1.2	-0.4	0.6	1.4	1.0	1.4	1.4
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	108.0	109.9	108.6	103.5	103.5	103.5	103.5	103.5
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	127.6	123.0	123.8	122.5	122.5	122.5	122.5	122.5
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / USD	41.3	40.6	40.6	40.6	40.6	40.6	40.6	40.6
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / Euro	55.7	55.7	55.7	55.7	55.7	55.7	55.7	55.7
Rritja reale e PBB	%	4.1	2.1	-4.0	8.7	4.1	4.2	3.9	3.9
PBB	Lek miliardë	1,636.7	1,691.7	1,617.5	1,769.3	1,867.4	1,964.8	2,070.9	2,183.2
PBB	USD miliardë	15.2	15.4	14.9	17.1	18.0	19.0	20.0	21.1
PBB	Euro miliard	12.8	13.8	13.1	14.4	15.2	16.0	16.9	17.8
PBB për banor	Lek një	571.0	592.7	570.0	624.8	661.1	697.5	737.5	780.2
PBB për banor	USD	5,287.7	5,395.7	5,246.1	6,034.7	6,385.0	6,736.8	7,122.9	7,535.8
PBB për banor	Euro	4,475.4	4,818.3	4,605.4	5,101.6	5,397.7	5,695.1	6,021.5	6,370.6
PBB për banor	USD-PPP	13,842.6	14,611.0	14,050.7	15,402.3	16,296.3	17,194.1	18,179.5	19,233.4
PBB për banor	Euro-PPP	10,246.7	10,647.8	10,239.5	11,224.5	11,876.0	12,530.3	13,248.4	14,016.5
Norma e papunësisë	%	13.0	12.9	12.2	11.4	10.3	9.4	8.9	8.5
Të ardhurat totale	% të PBB	27.5	27.2	26.3	28.6	28.7	29.0	29.1	29.2
Shpenzimet totale	% të PBB	29.1	29.1	33.2	34.5	34.1	31.9	31.9	32.0
Bilanci i përgjithshëm	% të PBB	-1.6	-1.9	-6.8	-5.8	-5.4	-2.9	-2.8	-2.8
Bilanci primar fiskal	% të PBB	0.6	0.2	-4.7	-3.8	-2.7	0.0	0.3	0.5
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	3.2	2.6	-0.5	2.3	1.0	2.2	2.4	2.7
Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (Neto)	% të PBB	64.6	64.8	75.2	75.3	77.1	76.1	74.7	73.2
Borxhi Publik (Bruto)	% të PBB	67.7	65.8	75.7	80.1	78.8	77.6	75.7	74.6
Borxhi publik i qeverisë së përgjithshme	% të PBB	64.9	63.3	72.7	76.2	74.8	73.9	72.6	72.1
Borxhi publik jashtë treguesve fiskale	% të PBB	2.8	2.5	3.0	3.8	4.0	3.7	3.1	2.5
Bilanci i llogarisë korrente	% të PBB	-6.8	-7.9	-8.8	-8.0	-7.3	-6.9	-6.2	-5.6
Bilanci tregtar (Mallra & Shërbime)	% të PBB	-13.7	-13.7	-14.8	-13.7	-12.5	-11.9	-11.0	-10.1
Mallra	% të PBB	-22.4	-22.9	-22.8	-24.3	-23.7	-23.4	-22.8	-22.2
Eksporte	% të PBB	7.7	6.6	6.1	8.3	8.0	8.3	8.8	9.0
Importe	% të PBB	-30.1	-29.5	-28.9	-32.5	-31.7	-31.7	-31.6	-31.3
Bilanci i pagesave	% të PBB	2.9	-0.6	5.0	0.6	2.3	3.3	3.0	3.4
Rezervat valutore	Euro milion	3,399.0	3,359.6	4,014.3	4,096.1	4,447.7	4,982.8	5,487.0	6,094.5
Në muaj importi mallrash e shërbimesh	Muaj	7.0	6.5	9.7	8.2	8.6	9.2	9.7	10.3

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka Botërore

Lidhja nr. 2/1 – Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në milionë lekë)

Nr.	E M E R T I M I	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
					Prithimi	Buxhet	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TË ARDHURAVE	449,909	460,346	425,905	506,890	536,811	569,737	601,792	636,994
I.	Ndihmat	8,164	10,606	8,294	12,000	13,994	14,958	13,967	13,365
II.	Të ardhura tatimore	419,333	426,271	396,658	473,290	500,167	531,879	564,435	599,629
II.1	Nga rrobat dhe doganat	304,318	304,756	278,364	336,789	360,535	383,726	407,307	433,661
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	21,863	23,102	21,975	27,059	27,632	29,153	30,528	31,968
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	93,153	96,411	97,639	109,443	112,000	119,000	126,000	134,000
III.	Të ardhura jo-tatimore	22,412	23,469	18,953	21,600	22,650	22,900	23,400	24,000
	TOTALI I SHPENZIMEVE	476,147	491,897	536,279	610,199	637,694	627,636	660,607	697,567
I.	Shpenzime Korrente	397,345	416,852	421,366	463,978	507,349	522,559	548,464	573,731
I.1	Personeli	73,582	76,962	76,896	83,310	91,590	96,292	94,226	96,476
	Paga	62,174	65,636	65,800	71,128	75,630	75,128	75,529	77,079
	Kontributi për sigurime shoqërore	10,304	10,579	10,562	11,482	12,460	12,364	12,798	13,498
	Fond / veçantë / pagave					300	500	500	500
	Politkat të reja pagash					2,400	4,400	4,400	4,400
	Arsim / lanë nga të ardhurat e veta	1,103	747	532	700	800	900	1,000	1,000
I.2	Interesat	36,513	35,143	34,393	36,300	50,757	57,421	65,451	71,338
	Të brendshme	23,158	22,838	22,351	23,600	27,363	32,452	36,234	40,217
	Të huaja	13,355	12,305	12,042	12,700	18,593	19,969	24,216	25,621
	Kontingencë për llogaritjet e normave të interesit, etj					4,800	5,000	5,000	5,500
I.3	Shpenzime operative e mirëmbajtje	45,498	47,215	46,906	58,794	63,241	59,492	61,465	63,715
	Të qeverisë qendrore / operative & mirëmbajtje				55,444	56,541	53,492	57,465	59,915
	Arsim / lanë				800	900	900	1,000	1,000
	Twining projects					500	500	400	
	Kontigjence vaksha					2,700	2,000		
	Të tjera jashtë limitit				2,550	2,600	2,600	2,600	2,800
I.4	Subvencionet	1,883	1,421	1,478	1,500	1,550	1,500	1,550	1,600
I.5	Shpenzime për fondet speciale	168,249	175,626	179,364	196,001	212,271	220,551	232,104	242,504
	Sigurime shoqërore	125,364	131,236	134,151	148,165	148,865	155,865	164,498	173,298
	Politkat të reja pensionesh					2,570	2,670	3,253	3,703
	Bonus / personelit					3,500	3,580	3,650	3,750
	Sigurime shëndetësore	40,154	42,118	43,289	45,636	52,836	53,436	55,022	55,752
	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	2,731	2,272	1,934	2,200	4,500	5,000	5,700	6,000
I.6	Buxheti lokal	49,615	56,227	51,626	59,073	60,290	62,353	65,618	68,548
	Grant / nga Buxheti / Shëtit për pushtetin vendor	27,753	33,124	29,651	27,789	28,028	28,670	29,870	31,200
	Fond / pakufizuar				18,480	18,723	19,870	21,070	22,350
	Grant Specific				8,206	9,305	8,800	8,800	8,850
	Transferte per emergjencat civile				1,103				
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)	21,863	23,102	21,975	27,059	27,632	29,153	30,528	31,968
	Taksa të ndara				970	1,040	1,080	1,120	1,180
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)				2,700	2,840	2,900	3,100	3,200
	Pranndim / huaj vendor dhe të tjera të mbartura				555	750	550	1,000	1,000
I.7	Transferte të tjera	22,004	24,257	26,703	29,000	27,650	27,950	28,650	29,550
	Pagesa e papunësisë	336	505	888	800	900	900	600	600
	Ndihma ekonomike dhe politike e famjeve, etj	20,671	20,189	23,996	25,000	23,550	23,850	24,250	24,700
	Kompensim për të përndjekurit politikë	997	1,199	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	2,000
	Bonus / Injleve		2,364	2,820	2,200	2,200	2,200	2,200	2,250
II.	Fond rezervë			12,052		2,900	3,500	3,400	5,400
	Fond rezervë / Këshillit të Këshillave					2,400	1,500	2,300	3,500
	Kosto e zgjedhjeve						1,000		1,000
	Paketa e mbështetjes sociale nga COVID			12,052					
	Kontigjence per projektet e BE					500	500	400	400
	Kontigjence "Oferta per famjet"					500	500	500	500
III.	Shpenzime kapitale	78,434	74,993	101,672	143,221	119,445	101,577	108,743	118,437
	Pranndim / brendshëm	51,552	50,641	58,547	78,394	62,766	61,117	65,413	68,387
	Transferte kapitale per AC					200			
	Arsim / lanë nga të ardhurat e veta	672	890	1,040	800	1,000	1,000	1,000	1,000
	Pranndim / huaj	26,210	23,462	24,494	29,028	34,502	37,660	40,430	46,550
	Nga të datat energjia		1,313	1,710	1,900	2,100	2,000	2,000	2,000
	Trans kapitale për llog. speciale të shpërndarjeve					1,178	1,800	1,900	2,500
	Fond / rindërtim pas tërmetit			16,591	35,000	20,000			
	Fond / rindërtim pas tërmetit (buxheti / shëtit)				35,000	20,000			
	Fond / rindërtim pas tërmetit (Grant)								
	Fond / rindërtim pas tërmetit (Kred)								
IV.	Detyrimet e prapambetura								
V.	Të tjera	368	53	988	0	8,000	0	0	0
	Hua e dhene per dis. energjie					8,000			
VI.	Fond shpronësimit	0	0	200	3,000	0	0	0	0
	DEFICITI FINANCIER DEFICITIT	-26,238	-31,546	-110,374	-103,309	-100,883	-57,900	-58,815	-60,573
I.	I brendshëm	26,238	31,546	110,374	103,309	100,883	57,900	58,815	60,573
	Të ardhura nga privatizimi	-6,866	40,932	46,426	-20,233	101,860	53,399	57,140	41,247
	Hua-narje e brendshme (neto)	104	242	238					
	Të tjera nga të datat	19,591	17,846	48,380	49,900	50,000	50,000	50,000	50,000
	Ndihmat / gjenjës së likuiditetit në TSA	-26,561	22,844	818	-70,133	51,860	3,399	7,140	-8,753
	Ndihmat / gjenjës së depozitës sig. ShoqëShend	-30,533	16,634	14,747	-76,133	51,860	3,399	7,140	-8,753
					6,000				
II.	I huaj	33,104	-9,383	60,548	123,542	-977	4,501	1,675	19,326
	Hua afatgjatë (e marrë)	83,761	20,493	97,467	100,220	24,252	86,700	89,920	95,540
	Per projekte	21,232	20,493	17,010	21,028	23,502	25,660	28,430	34,050
	Per rindërtimin nga tërmeti								
	Eurobond	62,529		80,457	78,637		60,490	60,490	60,490
	Nen-hua (Rushtet) vendor				555	750	550	1,000	1,000
	Ndihmat / gjenjës së ankës	106	-1,729	1,385					
	Rpagesat	-51,678	-29,791	-61,698	-34,120	-42,529	-82,199	-88,245	-76,214
	Eurobond	-25,012		-30,945			-30,245	-30,245	
	Këtuftim								
	Paga-bërje	-25,012					-30,245	-30,245	
	Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BE, BE etj)	916	1,643	23,793	57,442	17,300			
MEMO:									
	Balanca e përgjithshme (diferenca përgjithshme)	-26,238	-31,546	-110,374	-103,309	-100,883	-57,900	-58,815	-60,573
	Balanca korrente	52,197	43,444	-8,702	39,913	18,562	43,677	49,328	57,863
	Balanca përmare	10,276	3,594	-75,980	-67,009	-50,126	-479	6,636	10,764
	Gjenjës e likuiditetit në TSA (stok)	49,440	16,176	7,793	83,326	32,066	28,667	21,527	30,280
	Borxhi publik NETO nga gjenjës e likuiditetit në TSA (stok)	1,057,845	1,096,450	1,216,677	1,332,610	1,439,664	1,456,958	1,546,506	1,597,530
	Borxhi publik BRUTO (stok)	1,107,285	1,112,626	1,224,470	1,416,536	1,471,730	1,524,625	1,568,033	1,627,810
	Borxhi publik nga buxheti (stok)	1,061,897	1,070,191	1,175,235	1,348,667	1,397,690	1,452,191	1,503,866	1,573,192
	I brendshëm (stok)	565,093	582,136	630,791	680,691	730,691	780,691	830,691	880,691
	I huaj (stok)	496,804	488,056	544,434	667,976	666,999	671,500	673,175	692,500
	Borxhi publik jashtë buxhetit (stok)	45,388	42,434	49,245	67,869	74,040	72,434	64,167	54,618
	Pushtet vendor (stok)	716	582	432	350	650	750	900	900
	Borxhi publik / garantuar (stok)	44,672	41,853	48,813	67,519	73,390	71,684	63,267	53,718
	PBB nominale	1,636,730	1,631,727	1,617,541	1,763,258	1,867,351	1,964,760	2,070,862	2,183,169

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Lidhja nr. 2/2 – Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në përqindje të PBB)

Nr.	E M E R T I M I	2018	2019	2020	2021				
					Pritshmi	Buxhet	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TË ARDHURAVE	27.5	27.2	26.3	28.6	28.7	29.0	29.1	29.2
I.	Ndihmat	0.5	0.6	0.5	0.7	0.7	0.8	0.7	0.6
II.	Të ardhurat tatimore	25.6	25.2	24.6	26.8	26.8	27.1	27.3	27.5
II.1	Nga tatimet dhe doganat	18.6	18.0	17.2	19.0	19.3	19.5	19.7	19.9
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	1.3	1.4	1.4	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	5.7	5.8	6.0	6.2	6.0	6.1	6.1	6.1
III.	Të ardhura jo-tatimore	1.4	1.4	1.2	1.2	1.2	1.2	1.1	1.1
	TOTALI I SHPENZIMEVE	29.1	29.1	33.2	34.5	34.1	31.9	31.9	32.0
I.	Shpenzime Korrente	24.3	24.6	26.0	26.2	27.2	26.6	26.5	26.3
I.1	Personeli	4.5	4.5	4.8	4.7	4.9	4.7	4.6	4.4
	Paga	3.8	3.9	4.1	4.0	4.1	3.8	3.6	3.5
	Kontributi për sigurime shoqërore	0.6	0.6	0.7	0.6	0.7	0.6	0.6	0.6
	Fondi / veçantë / pagaive			0.0		0.0	0.0	0.0	0.0
	Politika të reja pagash			0.0		0.1	0.2	0.2	0.2
	Arsimi / lartë nga të ardhurat e veta	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
I.2	Interesat	2.2	2.1	2.1	2.1	2.7	2.9	3.2	3.3
	Të brandoime	1.4	1.3	1.4	1.3	1.5	1.7	1.7	1.8
	Të huaja	0.8	0.7	0.7	0.7	1.0	1.0	1.2	1.2
	Kontingjencë për luhajtë e normave të interesit etj			0.0		0.3	0.3	0.2	0.3
I.3	Shpenzime operative e mirëmbajtje	2.8	2.8	3.0	3.3	3.4	3.0	3.0	2.9
	Të qeverisë qendrore (operative & mirëmbajtje)		0.0	0.0	3.1	3.0	2.7	2.8	2.7
	Arsimi / lartë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Twining projects					0.0	0.0		
	Kontingjencë vaksina					0.1	0.1		
	Të ferra / ashtë lirimt	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
I.4	Subvencionet	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
I.5	Shpenzime për fondet speciale	10.3	10.4	11.1	11.1	11.4	11.2	11.2	11.1
	Sigurime shoqërore	7.7	7.8	8.3	8.4	8.0	7.9	7.9	7.9
	Politika të reja pensionesh			0.0		0.1	0.1	0.2	0.2
	Bonus / pensionist								
	Sigurime shëndetësore								
	Shpenzime për kompenzimin në vlerë të prararëve	0.2	0.1	0.1	0.1	0.2	0.3	0.3	0.3
I.6	Buxheti lokal	3.0	3.3	3.2	3.3	3.2	3.2	3.2	3.1
	Granti nga Buxheti / Shitjet për pushtet vendor	1.7	2.0	1.8	1.6	1.5	1.5	1.4	1.4
	Fondi / pakushtezuar		0.0	0.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0
	Granti Spedifik		0.0	0.0	0.5	0.5	0.4	0.4	0.4
	Transferte për emergjencat civile				0.1				
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)	1.3	1.4	1.4	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5
	Taksa të ndara		0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)		0.0	0.0	0.2	0.2	0.1	0.1	0.1
	Phandimi / huaj vendor dhe të tjera të mbartura		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
I.7	Transferata të tjera	1.3	1.4	1.8	1.6	1.5	1.4	1.4	1.4
	Pagesa e papunësisë	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Ndihma ekonomike dhe politika e famjeve, etj	1.3	1.2	1.5	1.4	1.3	1.2	1.2	1.1
	Kompenzim për të përfunduar politikë	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.0	0.1
	Bonus / llogjeve		0.1	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
II.	Fondi rezervë			0.7		0.2	0.2	0.2	0.2
	Fondi rezervë / Këshillit të Ministrave			0.0		0.1	0.1	0.1	0.2
	Kosta e zgjedhjeve			0.0			0.1		0.0
	Paketa e mbështetjes sociale nga COVID			0.7					
	Kontingjencë për projektet e BE						0.0	0.0	0.0
	Kontingjencë "Oferta për famjet"					0.0	0.0	0.0	0.0
III.	Shpenzime kapitale	4.8	4.4	6.3	8.1	6.4	5.2	5.3	5.4
	Phandimi / brendshëm	3.1	3.0	3.7	4.4	3.4	3.1	3.2	3.1
	Transferte kapitale për AC			0.0		0.0			
	Arsimi / lartë nga të ardhurat e veta	0.0	0.1	0.1	0.0	0.1	0.1	0.0	0.0
	Phandimi / huaj	1.6	1.4	1.5	1.6	1.8	1.9	2.0	2.1
	Nga të datat energjia	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
	Trans kapitale për llog. speciale të shpronësimeve								
	Fondi / ri-nordimit pas tërmetit			1.0	2.0	1.1			
	Fondi / ri-nordimit pas tërmetit (buxheti / shitjet)			0.0	2.0	1.1			
	Fondi / ri-nordimit pas tërmetit (Grant)			0.0					
	Fondi / ri-nordimit pas tërmetit (Kred)			0.0					
IV.	Detyrimet e prapambetura	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
V.	Tatjera	0.0	0.0	0.1	0.0	0.4	0.0	0.0	0.0
	Hua e dhene për sig. energjise					0.4			
VI.	Fond shpronësimit	0.0	0.0	0.0	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0
	DEFIÇITI	-1.6	-1.9	-6.8	-5.8	-5.4	-2.9	-2.8	-2.8
	FINANCIMI DEFIÇITIT	1.6	1.9	6.8	5.8	5.4	2.9	2.8	2.8
I.	I brendshëm	-0.4	2.4	3.1	-1.1	5.5	2.7	2.8	1.9
	Të ardhura nga privatizimi	0.0	0.0	0.0					
	Hua-marrje e brendshme (reto)	1.2	1.1	3.0	2.8	2.7	2.5	2.4	2.3
	Të ferra nga të datat	-1.6	1.4	0.1	-4.0	2.8	0.2	0.3	-0.4
	Ndihmat / gjendjes së likuiditetit në TSA	-1.9	1.0	0.9	-4.3	2.8	0.2	0.3	-0.4
	Ndihmat / gjendjes së depozitës sig. Shoqë Shend			0.0	0.3				
II.	I huaj	2.0	-0.6	3.8	7.0	-0.1	0.2	0.1	0.9
	Hua abtjglatë (e marrë)	5.1	1.2	6.0	5.7	1.3	4.4	4.3	4.4
	Për projekte	1.3	1.2	1.1	1.2	1.3	1.3	1.4	1.6
	Për ri-nordimit nga tërmeti			0.0					
	Buribordi	3.8		5.0	4.4		3.1	2.9	2.8
	Nën-hua (Pushtet vendor)				0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Ndihmat / gjendjes së ankës	0.0	-0.1	0.1					
	Ripagesat	-3.2	-1.8	-3.8	-1.9	-2.3	-4.2	-4.3	-3.5
	Buribordi	-1.5	0.0	-1.9			-1.5	-1.5	
	Maturim			0.0					
	Para-bleje			0.0					
	Mbështetje buxhetore (hua nga FMM, BB, BE etj)	0.1	0.1	1.5	3.2	0.9		-1.5	
	MEMO:								
	Balanca e përgjithshme (deficit) përgjithshëm	-1.6	-1.9	-6.8	-5.8	-5.4	-2.9	-2.8	-2.8
	Balanca korrente	3.2	2.6	-0.5	2.3	1.0	2.2	2.4	2.7
	Balanca primare	0.6	0.2	-4.7	-3.8	-2.7	0.0	0.3	0.5
	Gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	3.0	1.0	0.5	4.7	1.7	1.5	1.0	1.4
	Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	64.6	64.8	75.2	75.3	77.1	76.1	74.7	73.2
	Borxhi publik BRUTO (stok)	67.7	65.8	75.7	80.1	78.8	77.6	75.7	74.6
	Borxhi publik nga buxheti (stok)	64.9	63.3	72.7	75.2	74.8	73.9	72.6	72.1
	I brendshëm (stok)	34.5	34.4	39.0	38.5	39.1	39.7	40.1	40.3
	I huaj (stok)	30.4	28.8	33.7	37.8	38.7	34.2	32.5	31.7
	Borxhi publik jashtë buxhetit (stok)	2.8	2.5	3.0	3.8	4.0	3.7	3.1	2.5
	Pushtet vendor (stok)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Borxhi publik / garantuar (stok)	2.7	2.5	3.0	3.8	3.9	3.6	3.1	2.5
	PBB nominal	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Burim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë